



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Datë 17.03.2026

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.118/350-7813

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrërimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUPM në Suharekë lëshon këtë:

A K T V E N D I M

(MBI LEJEN NDËRTIMORE - OBJEKT BANIMI INDIVIDUAL)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:

Emri:	Bali Salihi	Adresa:	Rr."Sokol Salihi " Mushtisht-Suharekë	
Email:	/	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-7813 datë 12.02.2026	
Emri i Projektit:		Shtëpi e të riatdhesuarve P+0		
Emri i Projektuesit:		"Alb-Architect"SH.P.K. Prishtinë		
Adresa:		Rr. "Isa Kastrati", Nr 9		
Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI-OBJEKT INDIVIDUAL ME NJË NJËSI BANIMORE				
Adresa: rruga "Sokol Salihi ",Mushisht-Suharekë				
Zona(t) Kadastrale: Suharekë		Nr.i parc. kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
sipas çertifikatës 3079/2025 datë 03.10.2025 pronë e Bali (Aki) Salihi		02661-4 (713m ²)	Y= 7491077.731 Y= 7491081.645 Y= 7491086.662 Y= 7491082.748	X=4683776.174 X=4683782.921 X=4683780.010 X=4683773.263
Lloji i ndërtimit të propozuar:				
Objekt Individual me një njësi Banimore				
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:				
Kategoria I				
Sipërfaqja e përgjithshme Bruto e Objektivit:				
45.24m ²				
Sipërfaqja e përgjithshme Neto e Objektivit:				
36.12m ²				
Gabariti	45.24m ²	Etazhiteti:	P+0	

Vija rregullative	Sipas Aktvendimit mbi Kushte Ndërtimore: 07Nr.599/350-59271 datë 07.10.2025	Vija ndërtimore	6.0 m'nga aksi i rrugës Sokol Salihi 2.75 m'
----------------------	---	--------------------	---

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të Lejës ndërtimore Bali Salihi nga fshati Mushtisht-komuna Suharekë i lejohej ndërtimi i Objektit individual me një njësi banimore me etazhitet P+0 duke mos e tejkaluar koeficientin e ndërtimit dhe kushtet tjera të definuara me Hartën Zonale të Komunës, Kushteve ndërtimore dhe Udhëzimeve Administrative.

Lokacioni i objektit është në kuadër të HZK-së 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, konkretisht në Mushtisht, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela kadastrale 02661-4, ZK Mushtisht është tokë ndërtimore me destinim Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë ZB-2. Objekti do të ndërtohet sipas projektit të hartuar nga byroja projektuese: "Alb-Architect"sh.p.k., Prishtinë.

Objekti ka karakter të përhershëm me etazhitet P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.599/350-59271 datë 07.10.2025.

Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdheshë: 45.24m²

Kjo Leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse (të ofruara nga ana e palës gjatë tërë procesit të shqyrtimit të saj). Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet teknike dhe juridike të aprovuara për ndërtim të objektit. Çfarëdo ndryshimi i projektit kryesor duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj Leje Ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore, Projektuesin, Kontraktuesin dhe Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj Leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të Lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
 - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;

- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin e tyre, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi Bali Salihi nga fshati Mushtishti komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350-7813 datë 12.02.2026 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Objektit individual me një njësi banimore, sipas projektit të bashkangjitur. Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.599/350-59271 datë 07.10.2025 (kopje),
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.183/25 datë 29.10.2025, lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina "EKOREGJIONI" SH.A. Prizren, Njësia Operative – Suharekë,
- Vërtetim në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit–Hidroregjioni Jugor Prizren njësia Suharekë datë 28.10.2025,
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.431 datë 12.11.2025,
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.151 datë 05.03.2026,
- Tri kopje të projektit zbatues dhe një kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë,
- Koordinatat e vendosjes së Objektit sipas skicës së terrenit Nr te lëndës S001/2025 datë 02.12.2025 nga gjeodeti i licensuar Hekuran Demiri, me numër të licences 151
- Kopje e dokumentit Identifikues,
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.104/350-7813 datë 09.03.2026, taksa administrative 108.576€ dhe taksa e Infrastruktures 65.016€, gjithësej në shumë prej 174.592€, sipas faturës komunale nr. 001502 e paguar në zyra postare Therandë me datë 16.03.2026.
- Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, konform Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtimin e objektit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI-së në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit të lejes 07Nr.118/350-7813 datë 17.03.2026

Vendimi i dërgohet:- Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; Dosjes së DUPM-së

Drejtori i Drejtorisë:

Visar KUÇI

